

Procesverbal

I hartuar më 17.05.2021 në debatin me banor ne fshatin Sfeqel, ku ishin te ftuare edhe banoret e fshatrave Shajkoc, Dumosh, Balloc, Lladoc, Surkish, Hertice dhe Surdull.

Temë diskutimi ishte; Propozim Rregullorja per organizimin dhe bashkepunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Podujevës.

Drejtori i Administratës në komunën e Podujevës Bahri Selimi i cili edhe u drejtoi debatin, i informoi të pranishmit mbi të gjitha procedurat e kësaj propozim rregulloreje, e cila është hartuar në bazë te Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 mbi organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Në bazë të këti udhëzimi administrativ komuna e Podujevës duhet ti formoi 30 këshilla lokale. Me propozim rregulloren komunale është paraparë që 24 këshilla lokale të formohen nëpër fshatra dhe 6 ne qytet. Këto janë vetëm propozime dhe pas debateve dhe propozimeve dhe kërkesave banorëve mund të ndryshohen.

Kjo propozim rregullore qysh ne vitin 2020 ka dal ne diskutim publik por për shkak pandemisë kovid 19 është shtyrë, po ashtu edhe ne vitin 2021 nga asambleja komuna është shtyrë për një kohe ma te përshtatshme. Në mbledhjen e fundit asambleja komunale e ka qit në diskutim publik.

Florim Muqolli nga fshati Herticë ishte kundër qe fshati Herticë të jetë ne një këshill me fshatrat Balloc, Lladoc dhe Surdull. Fshati Herticë çdo herë ka qenë qendër lokale së bashku me fshatin Surdull. Edhe pozita gjeografik është një prej faktorëve qe nuk mundemi me qenë ne një këshill lokal me fshatrat Balloc dhe Lladoc.

Vehbi Podvorica nga fshati Dumosh propozoi që në çdo fshat të mbahen takime me banor dhe të informohen me këto propozim për formimin e këshillave lokale. Pra, te merret pëlqimi i banorëve.

Avdulah Softolli nga fshati Lladoc tha se kemi bisedua me komunitetin e fshatit te cilët nuk e kanë përkrahë këtë propozim për formimin e këshillave lokale. Fshati Lladoc me afro 300 shtëpi dhe nuk pranon që një banor i fshatit tjetër të përfaqësoi fshatin ton.

Islam Bekolli nga fshati Shajkoc përkrahi idenë që në çdo fshat të mbahen takime me banor dhe të merret vendimi për ose kundër formimit te këshillit lokal ku fshati Shajkoc bashkohet këtij këshill.

Abaz Llugaliu nga fshati Surkish tha se do të ketë vështirësi të zbatohet kjo rregulllore, kjo rregulllore si e tillë parqet veshtë ris edhe për institucionet qe te kenë komunikim sa ma te mire me komunitetin. Propozoi që çdo fshat- vendbanim që ka mbi 1,000 banor te ketë këshillin lokal te vetin.

Bahri Selimi tha i kuptoi se nuk do të jetë e lehtë formimi i këshillave lokale, duke pas parasysh numrin e madh të fshatrave dhe pozitën gjeografike te komunës së Podujevës.

Do të kërkoi takim me ministrin e pushtetit lokale, do të ia paraqes të gjitha kërkesat e komunitete neper këto debate dhe do te kërkoj nga ministri ndryshimin e udhëzimet administrativ.

Sfeqël,

Më 17.05.2021

Procesmbajtësi
Latif Mehmeti